

NJOHURIT NË KUR'AN

Allahume ente rabi la ilahe ila ente halekteni ve ene abduk

Ve ala ahdiqe ve vadike ma stetau eudhu bike min sherri ma sanat

Ve ebu'u leke bi nimetike aleje.Ve ebu'u bi dhenbi Fagfir li fe inehu la jagfiru dhunube ila ent Allahume Sali ve selim ala muhamedin ve ala alihi ve ash-habihi exhmein kema salejte ve barekte ala ibrahim ve ala alihi. ve limen tebeau bil ihsani ve bil dinuk ila jevmi din.

O Allahu ynë ti je Zoti im nuk ka të shënjtë e të adhuruar përveç Teje.Më ke krijuarë mua dhe unë jamë robi,sherbëtori i Ytë.

Dhe në besën që ta kamë dhën Ty dhe premtimin që ta kamë dhën Ty i përmbahem aq sa mundem.Kërkojë mbrojtjen tëndë mga të këqijat që i bëjë.

Të jamë mirënjohës për dhuntit e tua që mi ke dhënë.Dhe të jamë mirënjohës për jetën që ma ke dhënë.Falëm mua.Dhe vërtetë nuk mundë t ëna falë mëkatet kush pos Teje.

O Allah fale mëshirojë e përdhendete Muhamedin familjen dhe shokët e tij ashtu siq e përshendte e begatove dhe e shpëtove ibrahimin dhe familjen e tij.Dhe fali mëshiroi të gjithë ata pasojnë në rrugën e bëmirësisë dhe dinit Tëndë deri në ditën e Kijametit .Amin

Allahu na pranofhtë lutjet duatë agjerimin dhe namazin tonë.Amin

Allahu na lehtësoftë jetën e gurbetit,na shtoftë dashurinë dhe rrespektin mes veti neve që jemi këtu¹ dhe na i ruajtë familjet tona kudo që i kemi si dhe na mundësoftë që të takohemi me ta.Amin.

Kur'ani është teoria e tërë asajë që ne e shohim e nuk e shohim e dijmë dhe nuk e dijmë.Krejtë kjo botë ka një krijues-Allahun xh.sh, Ai krijues e ka shpallur kur'anin në të cilin përfshihen të gjitha njohuritë.Kur'ani ka zbrituar ta formoi personalitetin njëri e këtë personalitet ai e formon duke ia afruar njohurit e të gjitha gjërave.

Kur'ani është gjithëpërfshirës i njohurive prarijës i shkencave,në kur'an gjejmë njohuri për të kaluarën dhe të ardhëshmen. Duke pasë para syshë se Allahu ka ekzistuar qe para fillimit të ekzistimit të botës,njohurit përfshirëse në kur'an janë prej para krijimi dhe disa ngjarje e fenomene janë të përmenduara në mbrendin e Kur'anit.

Mësimet nga Krijuesi relevata apo vahji- shpallja nuk kanë fill vetëm me shpalljen e kur'anit por ato Datojne që nga mësimet hyjnore që Allahu ua zbriti apo u shpalli të dërguarve të zgjedhurve të Tij dedikuar popujve të më hershëm siç e thekson vetë Kur'ani në mbrendinë e tij

Mirëpo çështja e kuptimit të fjalës së shpallur tek popujt e ndryshëm është një shkencë në vete sidomos sa i përket Kur'anit (përfundimit të mësimet hyjnore) Kjo ngase Kur'ani është përmbledhësi i të gjitha shpalljeve të më hershme dhe anulimi i tyre

Qëllimi më i rëndësishëm i tijë është që synimet e lartë hyjnore të nguliten sepse njeriu i mëson më mirë përvetsonë me mirë atë që kërkohet nëse çështja përkatës parashtrohet duke iu përseritur me forma e stile të ndryshme e përshtatshme për psikologinë njerëzore.

Kur'an do te thote libër që lexohet nga fjala i e parë e tij ikre.I përbërë nga dy kopertina quhet mus-ah i ndarë ne 30 gjuse pjesë që kanë nga 30 faqe e 15 fleta pastaj indarë ne 60 harfe gjysëm gjusa 114 sure. Kaptina më e gjatë sureja bekare që ka 286. me e shkurta ajo kevther 3 me bismillah 4 ajete Sureja e parë fatiha e fundit nas. Sa i përket ajeteve disa e numrojnë edhe bismillahin ajet dhe numrojnë 6666 ajete disa pa bismilla 6634 ajete .

Është ruajtur nga koha e Muhamedit .a.s në atë mënyrë qe Muhamed mustafaja s.a.v.s si ia shpallte xhibrlili ua tregonte ua mësonte shokëve të tijë ata dikush e mësonte përmendësh e dikush e shkruante nepër lëkura devesh në rrasa guri apo në livore të hurmave.Shumë as-hab(Bashkëjetues te Muhamedit a.s) vetëtuan saktësinë dhe vendin e duhur të ajeteve

¹ Ky punim është pjesë nga ligjeratat e Ramazanit mbajtur ne Xhmin Shqiptare te Femrurve ne Oslo

të kur'anit kur e tuboi Ebu bekri r.a.Osmani r.a i shumëzoi 7 mus-hafe dhe i shpërndau nëpër qytetet e musimanëve.të gjitha ekzemplarët që gjinden sot janë identikë pikë për pikë.²

Kur'ani është i vetmi libër origjinal i ruajtur nga vetë shpallësi tijë Allahu xh.sh.Trashëguarë brezë pas brezi e gjeneratë pas gjenerate deri tek ne.Me leximin e tijë bëjmë ibadet Shpallja e pare ishte e perbere nga vetem pese versete te cilat jane pese versetet e para te kaptines 96. Nder shpalljet e para ishin suret 73, 74, 80 dhe 97.Kështu vazhdoi shpallaj për 23 vite..

Pastaj disa terma e tema përseriten për të na përkujtuar rëndësinë dhe kuptishmërinë e madhe e të rëndësishme që e kanë:P:Sh:

Në suren Rrahman është i përseritur 31 herë një ajet

Ne murselatë 10 herë një ajet

Në suren bekare 2 herë Pastaj fajla dituri dhe sinonimet e saje 851 here,etj.

Fjala ilm është e përmendur në kur'an 851 herë e ajo që e pranon diturinë që është dhurata më e madhe që na ka dhënë Allahu xh.sh.pra mendja el akl është e përmendur Akl 47 dhe disa herë më tepër në thirrjen a nuk po e shihni a nuk po e logjikoni a nuk po e mendoni.

Kurse fjala ikre është e përseritur tre herë me të cilën fjalë filloi shpallja e Allahut për te njeriu i ndëruar Muhamedi a.s.

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ *Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi.*³

Kur'ani është fjalë e Zoti i cili me bukurinë e të shprehurit dhe të permbajtjes ia tejkalon mundësitë dhe fuqitë e njeriut ai paraqet formilimin e fundit e definitiv hjnor të drjetuar mbarë gjinisë njerëzore.

Kur'ani është përmbledhës dhe tubues i frytit të të gjitha librave qiellore.Përmbledhës i të gjitha njohurive andaj sado që të shkruhet për të ai ende është në gjendje të japë e është burim i pa shterrshëm Për vertëtimin e këtij mendimi marrim dy nga ajetet nga mbrendija e vetë Kur'anit ku na kristalizohet kjo çështje shumë qartë.

فَلَوْ كَانَ الْبَحْرُ مِدادًا لِكَلِمَاتِ رَبِّي لَنَفَذَ الْبَحْرُ قَبْلَ أَنْ تَنْفَدَ كَلِمَاتُ رَبِّي وَلَوْ جِئْنَا بِمِثْلِهِ مَدَدًا

"Thuaj: Sikur të ishte deti ngjyrë për t'i shkruar fjalët e Zotit tim,deti(uji i tij) do të shterrej para se të përfundojnë fjalët e Zotit tim, e edhe sikur të sillnim shtesë edhe një si ai (deti)".⁴Si edhe ajeti tetër ku thuhet:..

وَلَوْ أَنَّمَا فِي الْأَرْضِ مِنْ شَجَرَةٍ أَقْلَامٌ وَالْبَحْرُ يَمُدُّهُ مِنْ بَعْدِهِ سَبْعَةُ أَبْحُرٍ مَا نَفِدَتْ كَلِمَاتُ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ

"Sikur të gjithë drunjët në tokë të jenë lapsa dhe sikur detit t'i shtohen edhe shtat dete(e të jenë ngjyrë) nuk do të mbaronin fjalët e Allahut".⁵

Asnjëherë nuk përfundojnë njohuritë për Kur'anin por urdhëri i përseritur në të është leximi ,ky urdhër është për gjithë njerëzimin sepse kur'ani është shpalluar nga Allahu për gjithë njerëzimin,kurse atyre që e besojnë u mbetet detyrë më me përgjegjësi,që ta mësojnë ta lexojnë.

Është simbolika e muslimanit leximi është rruga më e qartë dhe më e lehtë e ngritjes së njeriut në shkallë të lartë.Sepse shkalla e lartë e një njeriu është vetëm në sajë të diturisë,njohjes së gjërave e kjo arrihet duke lexuarë e studjuarë.

Njohja e gjërave të diturit e emrave ishte ajo që babain tonë babain e gjithë njerëzimit Ademin a.s e ngriti lartë dhe melektë ishin të urdhëruar t'ia bëjnë përluljen e nderimit.

Prandaj ne pasardhësit e tij Ademit a.s duhet të lexojmë shumë për ta qar në vendë trashigimin e nga ai.Pra Dituria.

Le të jetë ritmë i yni gjatë këtyre ditve e këtij muaji fjala Ikre

² Kalendar turkije 2006

³ Alek 1

⁴ S.Kehf 109

⁵ S.Llukman 27

Allahu na mundësoftë që të jemi përej atyre që me ikren jemi gjithënjë të shhoqëruarë.Amin

Ky muaj ka filluar me ikre dhe me ikre le të jetë i shoqëruarë tërë ora jonë tërë dita jonë tërë java jonë tërë ky muaj lexo ,lexo, Do te mundohemi qe gjate ketij muaji e edhe ne te ardhmen Inshalla t'u sjellim tema e ligjerata te ndryshme.